



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1022

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi – Kryetar, Kimete Gashi dhe Isa Hasani – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.Sh.T. Viktory Com, kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të KOMUNA E GJAKOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rrugës X” me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1, me 17/01/2025, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE N.Sh.T. Viktory Com me nr. 2024/1022 , e datës 21/10/2024, kurse vendimi i AK Komuna e Gjakovës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Rrugës X me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Obligohet Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjakovës të zbatoj vendimet e OSHP me numër PSH 2023/0572, 2024/0100, 2024/0534, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i Rrugës X me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1.

3. Urdhërohet Autoritetit Kontraktues – Komuna Gjakovë që në afat prej 5 ditësh kalendarike të njoftoj OSHP lidhur me zbatimin e vendimeve të OSHP të cekura sin ë pikën II të dispozitivit.

4. Mos respektimi i kësaj urdhërese në afat prej pesë ditësh kalendarike do ta detyrojë Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së dhe në të njëjtën kohë të kërkojë nga KRPP, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK-së /Komuna e Gjakovës, konform nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

5. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik N.Sh.T. Viktory Com.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 14.04.2023, Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Ndërtimi i Rrugës X me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1

Ndërsa me datën 04.10.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratë pune dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 4,357,000.00 €.

Me 10.10.2024, OE N.Sh.T. Viktory Com, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 15.10.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 21.10.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.Sh.T. Viktory Com me nr. 1022/2024 për lidhur me aktivitetin Ndërtimi i Rrugës X me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.Sh.T. Viktory Com janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankuesi pretendon se : “Në këtë pretendim OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar për arsye se nuk i ka plotsuar listën e makineris, duke theksuar se lista e makineris nuk është kusht për eliminim në bazë të Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Andaj në bazë të paisjeve të paraqitura është krijuar lista e makineris dhe në bazë të kësaj liste OE ankues pretendon se janë të gjitha makierit e paraqitur në dosjen e tenderit .Gjithashtu OE Ankues cek se në vendimin e OSHP: 2023/0560 / 0572 I datës 08/12/2023 është hudhur posht ekspertiza e këtyre ekspertëve dhe është bërë edhe njëhere ekspertize dhe gjatë seancës së mbajtur është shtjelluar kjo pikë e Dumpera-ve andaj edhe tek kjo pikë ,OE ankues pretendon se AK Komuna e Gjakoves po mundohet të manipuloj.OE ankues thekson se këtu nuk ceket fare, as pesha, as viti, as fuqia, por vetëm dumper 30 dhe në kllapa shkruan kamion andaj ju duhet të dini qfar kërkon, duhet të dini qfar të shkruani që të thirreni në këtë pik.OE ankuese thekson se ne e kemi plotsuar kete kriter ku kemi paraqitur 4 dumper si dhe 4 kamion.”

Pretendimi i dyte (II): “Në këtë pretendim OE ankues pretendon se .Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar me arsyjen se Vinci i cili eshte marre me qira nga NNP SIGMA nuk ka regjistrim. Dëshmi-Automjeti Vinç 05-812-GC terex afati i validitetin deri me 03-06-2023 pastaj vazhdimi 14-06-2024, Tek eliminimi i AK shihet qart se nuk ka marr per baze fare ankesen tone duke thene se ju keni paraqitur dokumentat per kete paisje vetem ne kerkesen per rishqyrtim te dates 10/10/2024 , pasi jeni eleminuar. Ky fakt qe deshmon nje papergjegjesi dhe shkelje te te drejtes per ankim ne AK komuna e Gjakoves.”

Pretendimi i trete (III) : “Në këtë pretendim OE ankues pretendon se .Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar me arsyen se nuk kemi paraqitur peshen per frez qe montohet ne bager. Dëshmi: Per shkaqe se kjo makineri perdoret ne shkemb te fort nuk mund te ruhet tabela e specifikimeve por nje hulumtim ne internet e paraqet deshmi te mjaftushme te kesaj makinerie me te gjitha specifikat e nevojshme. Pesha e simex tf 800 eshte 1035kg.”

Pretendimi i katert (IV) : “Në këtë pretendim OE ankues pretendon s AK. e Komuna e Gjakoves per riper hidrualike (Grremç) eshte paraqitur me kontrat blerje si dhe foto deshmi ne fajllat e ngarkuar , Kjo paisje perdoret ne shkamb te fort si dhe eshte aset i eskavatorit (bager).Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE N.Sh.T. Viktory Com konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 1, 6, 7, 28, 25, 38, 56, 59, 60, 69, 72, 108/A, 131 te LPP-se si dhe Neni 97 pika D dhe E, 43, paragrafi 5, 43, paragrafi 8, pika 1, 43, paragrafi 7, pika 1 te LPP-se.Organi Shqyrtues i Prokurimit që të kthehet lënda në rivlerësim dhe të shpallemi fitues në GOENSHT Viktoiy Coin, Esknvntory Company, dhe Marisa SHPK, ashtu siç e përcakton LPP dhe Tre vendimet e OSHP-së te leshuara per kete tender.

Përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim: Grupi i Operatorëve ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori SH.P.K; Marisa SH.P.K, nie dt.10.10.2024, ka parashtruar kërke.sës për ri-shqyrtim . lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Rrugës X”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurhnit- 632-23-397-5-1-1, Nr. I brendshëm-632-23-003-511. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës. me datë 15.10.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë: Sa i përket pretendimit 1: Ju njoftojmë se kërkesa për damperët ka qenë e qartë për të gjithë ofertuesit në këtë tndcr, ku në afatin e paraparë për sqarimc të dosjes së lenderit nuk është kërkuar sqarim, mirëpo në këtë fazc ju pretendoni se kërkesa është e pa qartë. Pas shqyrtimit të këluj pretendimi ju ri-thekscjmë se kërkesa për këtë pikë ka qenë e qartë dhe në këtë pikë ju nuk keni ofruar dëshmi se posedoni Dumper rnc peshë rminimum 30 ton dhe të cilat posedojnë certifikatën e regjistrimit të autoinjettit me afat valid, ku keni ofruar dëshmi se posedoni 4 Dumper të dëshmuar me DUD, si dhe shtesë keni ofruar 4 Kamiona kiper me certifikata të regjistrimit të automjetit të cilët nuk plotësojnë kërkesën për këtë pikë, kjo dukc u bazuar edhe në Vcndimin e OSHP-ës nr. 2023/0560 dt.O8.12.2023 (faqe 5 dhe 6) dhe ekspertes së saj ku kanë konstatuar se nuk mund të pranohen kamionët kiper si kamion Dumper. Andaj konsidcrojmë se kjo qeshje është e gjykuar tash nië nga OSHP dhe në këtë pikë nuk plotësohet krileri i kërkuar në DT. prandaj pretendimi juaj nuk qëndron; Sa i përket pretendimit 2 dhe pretendimi 3 të kërkesës për ri-shqyrtim ju njoftojmë si në vijim: dëshmitë e kërkuara me sqarime shtcsë nukjanë ofruar nga ana juaj.1. Dokumenti ku dëshmohe afati valid i vinçit me tablcta e regjislrimit 05-812-GC pronë e KNP “Sigma”, nuk është dëshmuar as në dokumentat e aplikimit për tender as në dokumentet e dorëzuar pas kërkesës për sqariinc shtesë. Një dokument i tillë nga ju, është ofruar vetëm në kërkesën për ri-shqyrtim të parashtrua ine datë 10.10.2024 pasi

qëjeni eliminuar, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron; 2. Dokumenti ku dëshinohe pëscha e frezës që montohet në bager dcrc 2t nuk është dëshmuar as në dokumentat e aplikinrit për tender as në dokumentet e dorëzuar pas kërkeses për sqarimc shtcsë. Një dokument i tillë nga ju, është ofruar vetëm në kërkesën për ri-shqyrtim të parashtria inc datë 10.10.2024 pasi që jeni eliminuar, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron; Pas kërimit lë sqarimeve shtesë ju keni shënuar në pikën

12 ,të listës së pajisjeve se keni këtë dëshmi: Luge Hidrualike Ripper (Grrcmç) I blere me fature dhe foto ne pronesi te Viktory Com. Ndërsa nga ju është kërkuar në sqarime shtesë: Kontrata e shitblerjes me person fizikeme Mentor Delija - ku mungonte dokumenti qe tregon specifikimin teknik për peshën dhe për ripper. Nga kërkitimi i dokumenteve të dorëzuara me sqarime shtesë nuk është gjetur as njëra nga dëshmitë e lart-cekura. Pra, ju si GOE nuk keni ofruar dëshmi se plotësoni

kërkesën për këtë pikë, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron; Ju si GOE nuk keni ofruar dëshmi se plotësoni kërkesën për pikën 22 të listës së pajisjeve përkatësisht për Cilindër me rrota hekuri me vibrim, min 8.0t, edhe pse ju është kërkuar me sqarime shtesë, sërish nuk është dëshmuar se është me rrota të hekurit dhe me vibrim, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron; Ju si GOE nuk keni ofruar dëshmi se plotësoni kërkesën për pikën 23 të listës së pajisjeve përkatësisht për pajisjen që keni ofruar Kamion DAF 450 me tabelat 05-698- A.I ku nuk është dëshmuar që shërben për spërkatje të bitumit dhe emulsionit, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron; Sa i përket shtimit material siç edhe ju e keni potencuar një vepriin i tillë nuk lejohej andaj dokumentet që i konsiderojmë si shtim material duke nisur nga lista e pajisjeve dhe dokumentet tjera ju kemi potencuar në letrën standardë që keni pranuar për eliminim, prandaj pretendimi juaj nuk qëndron. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.”

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 29/10/2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1022/2024, ndërsa me datë 15/11/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/1022, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues. Ndërsa OE është pajtuar me rekomandimin e ekspertit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE N.Sh.T. Viktory Com eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1022 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Eksperti shqyrtues, sqaron se pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, analizimit të fakteve dhe argumenteve AK gjatë fazës së hartimit të DT, duhet të jenë të qartë në vendosjen e kërkesave kualifikuese dhe dëshmitë e kërkuara, dhe bazuar në nenin 59 të LPP-së, në paragrafin 4, ku thuhet: *“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera*

të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Andaj ky pretendim ankimor është i BAZUAR ..”

Konstatimi i dyte (II) : “Eksperti shqyrtues, sqaron se pas shqyrtimit të pretendimit ankimore, analizimit fakteve dhe argumenteve ,analizimit të Letrës standarde e kërkesës për infomata të tenderit të dërguar nga AK-ja tek OE ankues në këtë rast ,konstaton se AK-ja me datën 13.09.2024 ka kërkuar infomata shtes. Është e logjikshme dhe e natyrshme se çdo licencë/librezë ka afat të skadencës dhe ai afat mund të skadojë me një afat të caktuar sikurse në rastin konkret, por kjo nuk do të thotë se e bënë ofertën e OE të papërgjegjshme në bazë të konstatimeve të tilla mbi bazën që nuk kanë mbështetje ligjore. Në bazë të rregullave dhe praktikave të prokurimit publik, kriter ligjor është që çdo dokument i dosjes të një OE të dorëzohet me validitet brenda periudhës së njoftimit për kontratë dhe ofertimit. Në këtë kontekst, rikujtojmë se në praktikat e prokurimit të gjithë jemi dëshmitarë që krijohen rrethana apo situata të tilla ku aktivitetet e prokurimit zgjaten e stërzgjaten siç është rasti konkret , dhe se vlefshmëria e licencës/Librezave mund të vazhdohet në përputhje me rregullat në fuqi. . Andaj ky pretendim ankimor është i BAZUAR.”

Konstatimi i trete (III) : “Eksperti shqyrtues, sqaron se pas shqyrtimit të pretendimit ankimore, analizimit infomatave/dëshmimeve shtes të dorëzuara nga OE ankues në këtë rast ,shihet se sqarimi i ofruar nga OE rreth peshës për Frezë është sipas kërkesës së AK-s të dërguar me datën 13.09.2024 por këto infomata janë ofruar në kërkesën për rishqyrtim dhe të cilat e sqarojnë peshën . Andaj ky pretendim ankimor është I BAZUAR .”

Konstatimi i katert (IV) : “Eksperti shqyrtues, sqaron se pas shqyrtimit të pretendimit ankimore, analizimit fakteve dhe argumenteve konstaton se AK gjatë vendosjes së Kërkesave kualifikuese në DT si : Kërkesa - Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. Dëshmia- Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim. OE Ankues në këtë rast ka plotësuar kërkesën e AK-s,duke dorëzuar Kërkesën Kualifikuese ashtu siç është kërkuar në Dt dhe Aneksin 7, mund ta dëshmojë kapacitetin e kërkuar nga AK-ja për Lugë hidraulike Ripper min. 2.5t maksimum 3t për këtë dhe pas kërkrimeve të markës të cilën e ka prezentuar me kontratë e njejta rezulton se nuk mundë të jetë me kapacitet mbi kërkesën e Ak-së. Andaj ky pretendim ankimor është i BAZUAR.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.Sh.T. Viktory Com Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.Sh.T. Viktory Com janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij si dhe mbështet rekomandimin e ekspertit dhe konstaton se lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i Rrugës X me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik N.Sh.T. Viktory Com te aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Ndërtimi i Rrugës X me numër të prokurimit 632-23-397-5-1-1, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetin e prokurimit dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion Paneli Shqyrtues, konstaton se për këtë aktivitet të Prokurimit janë nxjerrë disa vendime të OSHP me nr. PSH 2023/0560, 2023/0572, 2024/0090, 2024/0100, 2024/0534 dhe në të gjitha këto vendime edhe nga ana e ekspertëve shqyrtues por edhe nga Panelet Shqyrtuese është konstatuar se AK ka bërë vazhdimisht shkelje të dispozitave ligjore të LPP si, nenin 7, 59, 60, 62 të LPP, etj. dhe akteve nënligjore për prokurimin publik, dhe në asnjë rast nuk ka zbatuar në tërësi këto vendime edhe pse dihet mirë se vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim.

Po ashtu neni 105 paragrafi 2.16 i LPP-së sqaron se në rastet e përsëritura me të njëjtat pretendime ankimore, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, në rastet të cilat duhet të trajtohen si çështje të gjykuara “res judicata”. Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, edhe eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të trajtohet si e bazuar.

Paneli vlerëson se Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe komisioni i ri-vlerësimit gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk e ka marrë për bazë fare Vendimin e lartcekura të OSHP- së. Me këtë rast AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 97 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ku sipas këtij neni tek pika h), Mos respektimi i vendime të OSHP, konsiderohet shkelje e rëndë në Prokurimin

Publik.

Andaj, OSHP-ja urdhëron Autoritetin Kontraktues (AK) Komunën e Gjakovës, që të ndërmarr masa për zbatimin e vendimeve të lartpërmendur në afat prej pesë (5) ditësh, mos respektimi i këtij urdhri, në afat prej pesë ditësh kalendarike, do ta detyrojë panelin shqyrtues që të respektoj nenin 131 të LPP-së dhe njëkohësisht do të kërkojë nga KRPP-ja që ti anulojë licencën menaxherit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues (AK) Komuna e Gjakovës, në pajtim me nenin 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - N.SH.T. VIKTORY COM**
- Arkivës së OSHP-së: